



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduart Halimi, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Lindita Nikolla - ministre e Arsimit dhe Sportit

Arbër Mazniku - zëvendësministër i Arsimit të Lartë dhe Sportit

Plarent Ndreca - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit

Linda Pustina - drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit të Lartë

Erzen Tola - drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Arsimit

Adriana Berberi - drejtoreshë kabineti në Ministrinë e Arsimit

Aleksandër Xhuvani - anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë

Anila Paparista - anëtare e Komisionit të Arsimit të Lartë

Edmond Hajdëri - anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë

Gjergj Hamiti - këshilltar për mediet në Ministrinë e Arsimit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita të gjithëve!

Meqenëse plotësohet kuorumi, fillojmë normalisht mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

Ky është një projektligj mjaft i rëndësishëm për shkak të fushës që përpiket të rregullojë, por edhe për shkak të interesit të lartë publik rreth çështjes në tërësi dhe projektligjit në veçanti, në mënyrë të veçantë nga pjesa universitare.

Besoj se është një projektligj që ka interesin e veçantë të kolegëve deputetë. Kemi pasur të gjithë kohën e nevojshme ne edhe opozita për t’u njohur me projektin dhe për të bërë një diskutim të frytshëm në funksion të nevojës për të pasur një ligj sa më cilësor.

Ligji është një iniciativë e Këshillit të Ministrave, sjellë në Kuvendin e Shqipërisë, i iniciuar nga Ministria e Arsimit.

Sot kemi nderin të kemi të pranishme në komision ministren e Arsimit, zonjën Lindita Nikolla, së bashku me zëvendësministrin, zotin Mazniku, si dhe sekretarin e Përgjithshëm, zotin Ndreca. Gjithashtu, në këtë panel është zoti Xhuvani, anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë, si dhe ekipi tjetër që shoqëron ministren.

Ju falënderojmë, të gjithëve për pjesëmarrjen!

Fillimisht do të dëgjojmë, në mënyrë të përmbledhur, paraqitjen e zonjës Ministre në lidhje me përmbajtjen e projektligjit dhe qëllimin e tij, pastaj relatoren, zonjën Hysi, dhe më pas pyetjet e kolegëve deputetë.

Zonja Ministre, urdhëroni!

Lindita Nikolla – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sigurisht, ky është një projektligj tejet i rëndësishëm për shkak se prek çdo familje shqiptare, por, përtej prekjes së çdo familjeje shqiptare, ka të bëjë me një kapital të vyer të kapitalit njerëzor, i cili, sigurisht, projekton edhe gjithë kahun e zhvillimit shoqëror ekonomik dhe të gjitha fushave të vendit.

Ka qenë një nevojë emergjente ndërhyrja për realizimin e një reforme në sistemin e arsimit të lartë për t'u dhënë përgjigje problematikave që janë vënë re në këta 25 vjet të tranzicionit, për të vendosur rregull në zhvillimet kaotike në rregullimin e disekuilibrave midis arsimit profesional të degëve me interes publik dhe mbipopullimit të disa degëve, për të vendosur një standard të besueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në menaxhimin e zmadhimit sasior të pjesëmarrjes në institucionet tona të arsimit të lartë, duke e bërë sasinë edhe cilësi, për të bërë vlerësimin dhe konsolidimin pas dekadës së parë të aplikimit të kartës së Bolonjës e institucioneve tona të arsimit të lartë, diversifikimin e burimeve të financimit të arsimit të lartë, sigurimin e drejtësisë sociale përmes aksesit në arsimin e lartë të atyre që nuk kanë mundësi financiare, por që e meritojnë.

Projektligji “Për arsimin e lartë” që po diskutohet në këtë komision, është produkti i një procesi unik gjatë gjithë historisë së arsimit të lartë, i cili ka ardhur pas një konsultimi të gjatë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit.

Draftligji është produkt i punës së një komisioni ekspertësh të pavarur, larg interesave politike, gjithëpërfshirës dhe profesional.

Sigurisht jemi të ndërgjegjshëm se, si çdo reformë reale që sjell ndryshime rrënjësore, kjo nuk mund të jetë një reformë 100% konsensuale, por, ndryshe nga reformat e të shkuarës, nuk është një reformë e partisë në pushtet, nuk është një reformë e të zgjedhurve të politikës për të shkëmbyer privilegje me të zgjedhurit e trupës akademike. Kjo është një reformë për studentin dhe për pedagogët e tyre, një reformë që synon t'i japë vlerë mundit, kohës dhe financave të familjeve e taksapaguesve, duke siguruar që institucionet e arsimit të lartë të ofrojnë dije dhe cilësi.

Pa dyshim është reforma më e papolitizuar në këto 20 vjet. Kjo reforma vjen si proces unik pas dy dokumenteve strategjike, një angazhimi të gjatë dhe një debati publik të të gjithë aktorëve. Ndaj, gjej rastin të falënderoj edhe një herë punën e palodhur dhe profesionale të komisionit Gjonça, që gjetën forcën për të dalë mbi opinionet personale dhe për të dakordësuar një dokument thelbësor, i cili, pasi u debatua gjatë në të gjitha institucionet tona të arsimit të lartë dhe në grupet e interesit, kaloi në ministritë e linjës, dhe, pas redaktimeve përkatëse, u aprovua nga Këshilli i Ministrave.

Ky është një projektligj që sjell një mori ndryshimesh, cilat vijnë të gjitha në frymën e masave të ndërmarra deri tani. Kryefjalë mbetet cilësia në institucionet tona të arsimit të lartë,

pasi ne nuk bëjmë kompromis me cilësinë. Koha e universiteteve që bëjnë sikur japin mësim ka marrë fund. Përpara se të shpjegoj disa nga risitë dhe ndryshimet rrënjësore që sjell ligji, dua të ndaj disa momente tejet të rëndësishme.

Ky është një ligj për studentët shqiptarë, i cili synon të japë mundësinë që të rinjtë e këtij vendi të fitojnë nga universitetet dijet cilësore, të përfitojnë vlerën e munguar të mundit të tyre, si dhe t'u japë besimin prindërve që investimi, koha dhe financat do t'ia vlejnë. Kjo ka qenë e vetmja busull që ka orientuar gjithë këtë proces.

Gjithçka tjetër: ministria, universitetet, profesorati, autonomia, ligji, qeverisja dhe agjencitë, janë mjete në funksion të këtij qëllimi. Ligji ndryshon skemën e financimit, duke futur konceptin modern të financimit me bazë performancën. Shteti, sigurisht, do të jetë gjithnjë e më shumë financues i arsimit të lartë, por këto financa, taksat e qytetarëve shqiptarë, duhet të prodhojnë maksimumin e mundshëm të vlerës dhe një skemë moderne financimi që priret nga treguesit e performancës së universiteteve tona, do t'i shtyjë institucionet tona të arsimit të lartë të modernizohen, të përmirësojnë shërbimin e ofruar ndaj të rinjve, të gjenerojnë gjithnjë e më shumë kërkim shkencor, bashkëpunim të zgjeruar ndërkombëtar etj. Pra, në thelb ky projektligj do të prodhojë arsim të lartë gjithnjë e më cilësor.

Ligji bën më të drejtë financimin publik për studentin, duke iu gjendur pranë studentëve në nevojë, duke krijuar një formë të posaçme bursash për të gjithë kategoritë që në pamundësi financiare nuk i ndjekin dot studimet. Gjithashtu, krijohet një fond i posaçëm bursash për studentët që ndjekin degat më prioritet kombëtar, si dhe mbështet posaçërisht studentët me rezultate ekselence. Në këtë mënyrë do të optimizojmë mbështetjen me financim publik, duke u përqendruar tek ata që kanë më shumë nevojë, aty ku ka më shumë nevojë shoqëria dhe aty ku gjenerohet ekselencia. Ligji rrit ndjeshëm autonominë universitare, duke deleguar drejt universiteteve publike një sërë vendimmarrjesh të rëndësishme për numrin e studentëve të pranuar, për kriteret e përzgjedhjes, për përzgjedhjen e studentëve, për tarifat e studimit, për numrin e stafit akademik dhe për pagat e tyre. Ky është kantieri i parë i mirëfilltë i autonomisë universitare, si pjesë e besimit tonë që universitetet, në balancën midis lirisë së mirëfilltë dhe përgjegjshmërisë ndaj publikut, mund të ofrojnë cilësinë më të mirë.

Ligji modernizon qeverisjen e brendshme universitare, duke i dhënë autoritet të qartë senatit akademik mbi qeverisjen akademike të IAL-ve dhe mbështet punën me një strukturë administrative në shërbim të misionit të IAL-së. Në një koncept më modern të qeverisjes së

universiteteve rrisim cilësinë akademike, duke fokusuar akademikët në detyrat akademike, si dhe rrisim cilësinë e administrimit, duke u mbështetur atë tek administratorë profesionistë. Pra, ligji ka një cilësi të re në akademi dhe cilësi të re në administrim, dy vektorë të rëndësishëm, që do të prodhojnë një rezultante që i jep gjithnjë e më shumë cilësisë një frymëmarrje dhe një standard të ri.

Sigurisht, nuk do të ketë më IAL, pra pjesë të sektorit të IAL-ve, që shihen me standarde të ndryshme, pasi do të kemi një sistem qeverisës, një set standardesh të trupëzuara në një kod cilësie, një sistem sigurimi cilësie, si dhe pa dyshim një sistem kontrolli të unifikuar të ligjshmërisë. Një sistem i drejtë konkurrence do të mundësojë kështu një arsim të lartë cilësor.

Ligji krijon mundësinë e diversifikimit të financave. Por, të nderuar deputetë, më lejoni të ndaj një jo, të prerë. Ky ligj nuk çon para publike drejt institucioneve private. E kundërta është e vërtetë: ligji mundëson rritjen e financimit publik dhe privat drejt arsimit publik, po ashtu çon drejt rritjes ofruesit e shërbimit publik në arsimin e lartë, duke u dhënë një mision të ri institucioneve të arsimit të lartë. Ne e shohim këtë shërbim si një të mirë publike, por edhe një përgjegjësi publike.

Ligji krijon të gjitha mundësitë që në kushtet e kontrollit rigoroz institucionet jofitimprurëse të arsimit të lartë të shndërrohen në institucione ofruese publike të arsimit të lartë. Kështu krijojmë mundësinë për transformim të IAL-ve të pavarura, si ente publike moderne, që ofrojnë një shërbim publik në lirinë më të madhe, sipas modeleve më moderne të suksesshme ndërkombëtare.

Ligji krijon mundësitë e modernizimit të kërkimit shkencor në universitetet tona, duke e kthyer kërkimin shkencor në një tregues të matshëm dhe të krahasueshëm të cilësisë në universitet. Sigurisht, ky shndërrohet në një kriter të rëndësishëm për financimin e IAL-ve, duke i shtyrë universitetet të kthehen gjithnjë e më shumë në qendra të zhvillimit dhe të inovacionit.

Ndajmë qartësisht dhe ridimensionojmë tri rolet e shtetit në arsimin e lartë:

Së pari, rolin rregullator, si vendosës i standardeve dhe rregullave të funksionimit, por edhe si garantues i funksionimit të sistemit dhe të cilësisë.

Së dyti, rolin e financuesit të arsimit të lartë, duke financuar institucionet ofruese të shërbimit, por edhe duke mbështetur përfituesit.

Së treti, rolin e drejtpërdrejtë të ofruesit të shërbimit nëpërmjet IAL-ve publike.

Ligji ridimensionon agjencitë ekzistuese, duke i afruar me modelet më të mira europiane dhe duke modernizuar shërbimet e ofruara prej tyre.

Sigurisht, thënë sa më lart, kjo reformë është një sfidë e përbashkët, por që pa dyshim është e njëjtë me modelet bashkëkohore, që sigurojnë standarde të reja të cilësisë.

Më lejoni, të nderuar deputetë, të ndaj me ju edhe disa momente të rëndësishme të ekspertizës ndërkombëtare që kanë ardhur posaçërisht për projektligjin e ri të arsimit të lartë. Ndërkohë, ju bëj me dije që nesër dhe pasnesër në Vlorë BE-ja realizon një tryezë të përbashkët për arsimin me ministrat e Ballkanit Perëndimor, ku kryefjalë do të jenë referencat e të gjithë punës së deritanishme të bërë nga Ministria e Arsimit dhe qeveria shqiptare me reformat në arsim. Pa dyshim, kryefjalë mbetet jo vetëm gjithçka që ne realizuam me verifikimin e kriterëve të ligjit në IAL-të tona, që çoi në mbylljen e 18 institucioneve të arsimit të lartë privat, por sigurisht procesi i rëndësishëm që do të sjellë ky ligj pas implementimit në IAL-të tona.

Profesor Lorenc Ornagi, rektor i universitetit katolik të Milanos dhe ministër i trashëgimisë dhe kulturës gjatë periudhës 2011-2013, i ka prezantuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit opinionin e tij në lidhje me ligjin e ri “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, ku ka theksuar që reforma në arsimin e lartë ka këto karakteristika pozitive:

“Dispozitat janë shkruar me qartësi dhe saktësi. Rruga e zgjedhur, ajo e rinovimit të sistemit universitar, duke parë drejt të ardhmes, është politikisht e vështirë, por unë personalisht mendoj se, pavarësisht nga vështirësitë, kjo rrugë është më e preferueshme sesa thjesht riorganizimi i sistemit ekzistues”.

Eksperti britanik për çështjet e arsimit të lartë, profesor Stiv Bristo, i kontaktuar nga këshilli britanik, i ka dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit vlerësimet dhe sugjerimet e tij për projektligjin e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor. Ai shprehet se draftligji përfaqëson një përmirësim sinjifikativ krahasuar me ligjin e mëparshëm, megjithëse është i shqetësuar për nivelin e detajeve që rregullon, duke gjykuar se disa elemente mund të ishin lënë për t’u rregulluar me akte të tjera nënligjore.

Pra, janë shumë pasazhe që vijnë nga ekspertiza ndërkombëtare, të cilat mund t’jua vëmë në dispozicion. Sigurisht, do të ketë edhe një konferencë me rektorët dhe me përfaqësuesin e Brukselit, drejtorin e Përgjithshëm të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Përtej kësaj, më lejoni t'ia jap fjalën profesor Xhuvanit, për të sqaruar me detaje të gjitha risitë që sjell ligji në kapituj të veçantë, që kanë si kryefjalë cilësinë dhe modernizimin e sistemit.

Fatmir Xhafaj – Patjetër, zonja Ministre.

Për sa kohë, siç e parashikuat edhe ju vetë, ky është një produkt i qeverisë shqiptare, por i realizuar në një formë krejt të veçantë, gjithëpërfshirës dhe profesional, nëpërmjet një komisioni të nderuar. Besoj se zoti Xhuvani përfaqëson atë komision të nderuar sot në këtë sallë.

Aleksandër Xhuvani – Mirëdita, i nderur zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zonja Ministre, zoti sekretar i Përgjithshëm,

Unë do të bëj një përmbledhje shumë të shkurtër të kapitujve që ka ligji, gjithsej 13, duke u përqendruar në thelbin e çdo kapitulli dhe në risitë që ai sjell në përputhje me dokumentet strategjike të BE-së, por edhe më gjerë.

Në kapitullin e parë të ligjit jepen parimet e përgjithshme, mbi të cilat ky ligj mbështetet dhe ngrihet sistemi i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me procesin e Bolonjës, të cilin Shqipëria e ka firmosur në 2003-shin, si dhe rekomandimet e BE-së në këtë fushë.

Arsimi i lartë përcaktohet qartazi në kapitullin e parë si një e mirë dhe përgjegjësi publike dhe mbështetet në katër parime thelbësore, që janë: mundësi të barabarta, meritokraci, konkurrencë mbi standarde të njëjta dhe autonomi i IAL-ve. Kur flasim për autonomi nisemi nga përkufizimi ndërkombëtar i parimit të autonomisë universitare dhe lirisë akademike.

Në kapitullin e dytë jepet skema makro e organizmit të sistemit të arsimit të lartë me gjithsej pesë agjenci, një pjesë e të cilave rristrukturohen, një pjesë ndërtohen nga e para dhe bëhet fjalë për Komisionin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor që është pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Qendrës së Shërbimeve Universitare, e cila asiston të gjithë kandidatët që duan të integrohen në arsimin e lartë.

Më pas, në një rend me autonomi më të rritur vijnë Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë.

Më pas, me një status të pavarur është Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Shqiptare.

Në kapitullin e tretë jepen organizimi dhe llojet e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë sipas parashikimeve që bën ky ligj me statusin juridik, së pari në IAL-të publike, në IAL jo publike, edhe në bazë të përcaktimeve të Kushtetutës dhe në IAL-të publike të pavarura, për të cilat do të ndalem në kapitullin e dymbëdhjetë që i dedikohet këtij lloji institucioni. Ky ishte statusi juridik, që për nga lloji do t'i ndajmë në universitete, akademi, kolegje universitare dhe kolegje profesionale të larta, duke u dhënë mundësi të gjithë atyre që, për shkak të performancës në arsimin parauniversitar, nuk mund të integrohen në sistemin e arsimit të lartë, të kenë mundësi të përftojnë një formim deri në 2-vjeçar pas maturës për t'u përshtatur me nevojat e tregut të punës.

Kapitulli i tretë futet më në detaje të funksionimit dhe të institucioneve të arsimit të lartë. Aty flitet për njësitë përbërëse duke u nisur nga njësia kryesore, që është fakulteti, por që mund të jetë edhe një institut i kërkimit shkencor; më pas në njësinë bazë, që është departamenti, por edhe njësitë ekuivalente me të, të cilat shërbejnë si njësi bazë, që janë qendrat kërkimore shkencore, studimore, ndërdisiplinore, qendra shëndetësore universitare dhe degët e institucioneve të arsimit të lartë duke hequr fjalën “filiale”, që është një fjalë e huaj dhe duke i dhënë kuptimin që ka në gjuhën shqipe vetë fjala degë e institucionit të arsimit të lartë.

Kapitulli i katërt ka të bëjë me hapjen, mbylljen, riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, fillimin e veprimtarisë së tij, raportimin, statutin e arsimit dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë. Këtu duhet thënë që ka pasur një konfuzion në diskutimet dhe debatet që janë bërë, pasi në ligj nuk bëjnë më pjesë dy strukturat e institucioneve të arsimit të lartë që janë në ligjin aktual: Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Profesorëve. Në fakt, nuk është kështu. Ligji parashikon komisione të përhershme, nga të cilat njëri është i detyruar, pasi, siç do të flasim më poshtë, i delegohet institucionit të arsimit të lartë e drejta për të dhënë vetë titullin “Profesor”, siç nuk e ka ligji aktual i arsimit të lartë, dhe për pasojë një komision i përhershëm, që ka të bëjë me karrierën akademike, është i detyrueshëm.

Më pas, struktura e fakultetit, departamentet apo institucionet e arsimit të lartë i lihen në dorë institucionit të arsimit të lartë dhe nëse duam, mund ta vendosim në statut Këshillin e Profesorëve dhe Këshillin e Fakultetit, por të personalizuar sipas fakulteteve, aftësive dhe specifikave që ato kanë.

Duhet thënë që në kapitullin e katërt ka një risi në emërtimin e institucionit të arsimit të lartë, ku hiqet e drejta që në emrin e përveçëm të vendoset statusi juridik i institucionit. Në të

kaluarën ka qenë shkolla e lartë universitare universiteti iks, dhe duke qenë se “Universiteti” është status juridik, nuk do të bëjë pjesë në emrin e përveçëm, por do të mbajë statusin juridik që ka institucioni i arsimit të lartë dhe emrin e përveçëm, siç e gjykon ai ta ketë.

Kapitulli i pestë ka të bëjë me organizimin dhe autoritetet drejtuese të universitetit, që janë dy kolona kryesore: është kolona e parë akademike dhe ajo administrative. Në organizimin akademik kemi senatin akademik dhe funksionet, rektorin dhe rektoratin, këshillin e etikës, asamblenë e personelit akademik, e cila është trupa zgjedhore e institucionit të arsimit të lartë, më pas dekani dhe dekanati, përgjegjësi i departamentit dhe komisionet e përhershme.

Pjesa e dytë e kapitullit të pestë, kolona e dytë, Autoritetet Drejtuese në Institucionet e Arsimit të Lartë ka të bëjë me organet drejtuese administrative. Bëhet fjalë për bordin administrativ dhe funksionet, të rritura në ligjin që paraqesim, administratori dhe funksionet, administratori i njësisë kryesore dhe administratori i njësisë bazë, dhe këtu duhet ta heqim perden e konfuzionit që është krijuar, pasi administratori i njësisë bazë nuk është skemë e detyruar, e vendos përsëri në nivel institucioni nëse duhet të kenë administrator të njësisë bazë ose jo.

Duhet thënë që dualiteti, kolonë administrative dhe kolon akademike nuk është një shpikje e jona, por është një huazim i ideve dhe parimeve të modelit anglez mbi të cilin është mbështetur kryesisht komisioni i paraqitur ndaj këtij ligji.

Në kapitullin e gjashtë trajtohen personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ, statusi, kategoritë e personelit akademik, profesorët, lektorët, asistentlektorët, titujt akademikë dhe mënyra e fitimit të tyre, personeli ndihmës akademik administrativ, punësimi dhe karriera.

Në kapitullin e shtatë flitet për organizimin e studimeve tërësisht konform procesit të Bolonjës. Këtu ndahemi në dy drejtime: studime me kohë të plotë, por heqim fjalën anglisht *part time* dhe vendosim një term shqiptar: studime me kohë të zgjatur, që do të thotë se studenti do të marrë të njëjtën sasi informacioni si në studimet me kohë të plotë, por në një afat kohor më të shtrirë, në tri cikle studimi, duke futur studimet profesionale dhe riintegrohet edhe masteri ekzekutiv. Në vitin 2007 në ligjin e arsimit të lartë ishte master i nivelit të dytë, i cili u hoq në vitin 2010 dhe ne e riintegrojmë, pasi kjo nuk është një risi, por është, si të themi, një realitet i shumicës së vendeve të Bashkimit Europian. Për çdo cikël studimi sqarohet: pranimi, titujt e lëshuar, njohja, transferimi, kodifikimi i titujve, gjuha, programet e përbashkëta e të tjera.

Në kapitullin e tetë flitet për kërkimin shkencor, ku përcaktohet veprimtaria kërkimore-shkencore, struktura e kërkimit shkencor, kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë, por ndonjëherë edhe në range publike, institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkimit të zhvillimit apo kërkimit shkencor.

Në kapitullin e nëntë flitet për studentët dhe të dhënat mbi ta, fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve në përputhje të plotë me procesin e Bolonjës dhe të gjithë dokumentet që kanë të bëjnë me këtë çështje, këshillat e studentëve, karta e studentëve, dokumentacioni i procesit mësimor dhe baza e të dhënave të studentëve në institucionin e arsimit të lartë.

Në kapitullin e dhjetë flitet për sigurimin e cilësisë, ku në mënyrë të veçantë për sigurimin e brendshëm dhe sigurimin e jashtëm të saj, kodin e cilësisë së arsimit të lartë dhe procesin e akreditimit.

Në kapitullin e njëmbëdhjetë flitet për pronat dhe financimin e arsimit të lartë. Këtu do të zgjatesha pak më shumë për të thënë që parimet bazë në financimin e institucionit të lartë sipas këtij projektligji, nga buxheti i shtetit bëhen duke u mbështetur mbi autonominë financiare të institucioneve të arsimit të lartë dhe shpjegohen burimet e financimit për institucionet publike të arsimit të lartë.

Zonja ministre e qartësoi që është krijuar një konfuzion, duket sikur është hapur një lojë ku paratë publike shkojnë edhe te privati. Nëse doni, unë mund ta sqaroj tani. Janë dy zëra që mundësojnë institucionet private apo jopublike të arsimit të lartë të përfitojnë nga fondet publike: është fondi i ekselencës, pra u jepet një bursë studentëve të shkëlqyer, kandidatëve të shkëlqyer që kanë mbaruar me sukses ciklin parauniversitar dhe ata e zgjedhin me dëshirën e tyre institucionin. Këtu nuk mund të ndërhyjë më shteti për t'u thënë që duhet të shkojnë detyrimisht në institucionet publike.

E dyta, janë projektet e kërkimit shkencor. Për sa kohë që rezultati dhe produkti i kërkimit shkencor mund të ketë valencë dhe ndikim në nivel kombëtar, nuk kemi pse t'i përjashtojmë nga kjo garë. Do të jetë një garë akademike dhe të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë detyrimin ligjor do të kryejnë kërkim shkencor.

Shpërndarja e fondeve nga buxheti i shtetit ka të bëjë me grantin e politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, grantin e mësimdhënies dhe grantin e punës kërkimore-shkencore të veprimtarive krijuese. Këto janë tri buxhetet.

Për buxhetin e parë kemi fondin për mbështetjen e institucionit dhe mbështetjen e infrastrukturës akademike vetëm për institucionet e arsimit të lartë publik.

Kemi fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë, përsëri vetëm për publikun.

Granti i mësimdhënies ka të bëjë me fondin për institucionet publike të arsimit të lartë dhe është një formulë e re që tashmë nuk merr në konsideratë vetëm ata që futen në universitet, por edhe cilësinë e atyre që formohen nga universiteti dhe se sa ata e gjejnë veten në tregun e punës.

Në fondin e mbështetjes studentore kemi bursat e studentëve të shkëlqyer, për të cilat fola, bursat e studimit për studentët me programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, pra nuk duhet të marrë në gojë degë të ndryshme të zhvillimit akademik në institucionet e arsimit të lartë, por shteti ka të drejtën legjitime të bëjë politika mbi arsimin e lartë duke përcaktuar kriteret kombëtare. Këto mund të jenë shkencat e natyrës, shkencat e mësuesisë, inxhinierisë e të tjera.

E treta, janë bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë.

Për sa i përket pronës dhe financimit në arsimin e lartë, granti i punës së kërkimit shkencor ndahet në tri çështje: fondet për studimet e doktoraturës, pra, departamenti nuk mund të marrë doktorantë pa kufij nëse nuk ka një projekt të mirëfilltë kërkimor për të cilin ka kërkuar edhe një mbështetje financiare; granti i infrastrukturës, që është për publikun; dhe i fundit, granti i projekteve kërkimore, që është i hapur për të gjitha institucionet e arsimit të lartë që kanë detyrimin ligjor të kryejnë kërkim shkencor.

Kapitulli i njëmbëdhjetë bën fjalë për kreditë studentore, kreditë për institucionet publike të arsimit të lartë, kontrolli dhe auditimi, pronat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Kapitulli i dymbëdhjetë dhe më i debatuari ka të bëjë me institucionin publik të pavarur të arsimit të lartë, flitet për nocionin e IALKP-së, kriteret e krijimit, mënyrat e krijimit, bordi i administrimit, administrimi i fondeve, inspektimi i veprimtarisë së IALKP-së.

Shpeshherë është bërë pyetja se çfarë është kjo gjetje. Në fakt, nuk është gjetje. Emërtimi është disi i veçantë, por duhet thënë që në Britaninë e Madhe vetëm më pak se 5% të institucioneve të arsimit të lartë nuk janë të kësaj kategorie, 95% janë të kësaj kategorie. Në Itali ka disa syresh nga më prestigjiozet, ndër të cilat edhe Universiteti i Bokonit. Në Portugali janë mbi 50% e këtyre institucioneve që kanë këtë status. Në Francë 14 institucione kanë përsëri këtë

lloj funksionimi dhe janë krijuar duke filluar nga viti 1875. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ia vlen të flasim, sepse të gjitha institucionet më prestigjioze të këtij vendi funksionojnë nën këtë skemë.

Kapitulli i trembëdhjetë dhe i fundit bën fjalë për dispozitat kalimtare dhe mbështetet mbi parimet kushtetuese, siguron vijueshmërinë e funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë pa lënë asnjë lloj vakumi institucional.

Ju kërkoj ndjesë nëse u zgjata dhe ju falënderoj për vëmendjen!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, profesor!

Besoj se këtu mbyllet pjesa që ka të bëjë me prezantimin e projektit dhe fjalën e ka relatorja e projektligjit, zonja Vasilika Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Më lejoni para së gjithash të falënderoj ministren Nikolla, stafin, dhe në mënyrë të veçantë ekipin e ekspertëve që kanë ndërmarrë reformimin e ligjit të arsimit të lartë.

Deri më sot arsimi i lartë rregullohet me ligjin e vitit 2007, por mjafton një lexim i thjeshtë i ligjit që është në fuqi me projektligjin që ne po diskutojmë sot për të kuptuar se çfarë revolucioni sillet në arsimin e lartë me miratimin e këtij ligji.

Nëse do të më lejoni, zoti kryetar, edhe në cilësinë e relatores, të shprehja vlerësimin tim, në radhë të parë, për procesin e hartimit të këtij projektligji meqenëse e kam ndjekur me vëmendje të veçantë, sikurse kam ndjekur me vëmendje të gjitha debatet dhe diskutimet në publik, por edhe midis ekspertëve, si edhe të jap disa vlerësime duke përfshirë edhe disa pyetje që unë kam në cilësinë e relatores për problemet që janë esenciale në ligj dhe duke rezervuar më pas të drejtën e diskutimeve nën për nën dhe të mundësisë së rishikimit, qoftë nga pikëpamja e teknikës legjislative apo të ndryshimeve të nevojshme që mund të dalin edhe në bazë të diskutimit që do të bëjmë në këtë komision.

E vlerësoj procesin që keni ndjekur për faktin se nuk ishte një proces politik, ishte një proces ku ju përfshitë ekspertë të të gjitha fushave, vendas dhe të huaj, të profesioneve të ndryshme, dhe kjo është për t'u përgëzuar, sepse me të drejtë pajtohem me atë që tha ministrja Nikolla, që është një proces që qëndroi larg politikës, pavarësisht se pati tendenca për t'u politizuar.

E dyta, vlerësoj faktin që ishte një proces që mori kohën e vetë, pra nuk u bë me nxitim, pati një periudhë të gjatë diskutimi. Madje, kam pasur mundësinë t'i ndjekë dhe t'i lexoj të gjitha variantet që ju keni hedhur në diskutim, por këtë e kanë pasur edhe të gjithë qytetarët dhe të gjithë personat e interesuar. Kam bindjen, edhe pasi kam lexuar variantin që ju keni sjellë për miratim në parlament, se ky variant është shumë më i mirë se të gjitha variantet që ju keni hedhur në diskutim në tryezat e mëparshme, çka tregon që procesi i ndjekur nga ekspertë të fushës larg politikës me përvoja brenda dhe jashtë vendit, edhe me gërshetim të moshave dhe të *background*-eve të tyre, bëri që ky proces të rridhte me gjithë debatet dhe kritikën, por kam bindjet që edhe nga kritikën grupi ka përfituar dhe ligji është përmirësuar.

E treta, më lejoni t'ju falënderoj për procesin e konsultimit publik të hapur që bëtë dhe të debateve që keni bërë jo vetëm në universitete, por edhe falë ndjeshmërisë që pati media, e cila mundësoi që ky proces të mos mbetet brenda dyerve të mbyllura, siç janë bërë shumë ligje, të cilat më pas janë bërë objekt debatesh dhe diskutimesh, madje deri në Gjykatën Kushtetuese!

Fakti që ju bëtë një proces kaq të hapur, të gjerë dhe që keni reflektuar në pjesën më të madhe të problematikave për të cilat profesoritet e universiteteve në Tiranë dhe jashtë saj kanë pasur, edhe për koha e mjaftueshme që iu dhatë, mendoj se keni arritur në një projektligj, i cili do të sjellë vërtet një reformim të arsimit të lartë.

Unë do të doja të theksoja që në fillim, që miratimi i këtij ligji nuk do të thotë që arsimi privat do të vihet menjëherë në zgjidhje, por të paktën do të krijohet mundësia që nëpërmjet këtij ligji të rritet ajo që themi, konkurrenca dhe të gjitha universitetet që ofrojnë arsimin e lartë të rrisin performancën e tyre.

Në cilësinë e relatores së këtij projektligji, kolegë dhe ju përfaqësues të grupit të punës, them se komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, çka do të thotë që ne nuk do të hyjmë në çështje teknike, të cilat mund të shikohen ose të diskutohen më mirë në Komisionin e Arsimit, por do të shikojmë 3 aspekte të rëndësishme. Projektligji që ka sjellë qeveria është sjellë konform Kushtetutës, respekton Rregulloren e Kuvendit. E para.

Dhe e dyta, është përmbajtja e këtij projektligji. Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën? A është në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, meqenëse kemi dy vendime të Gjykatës Kushtetuese që kanë bërë objekt shqyrtimi ligjin që është në fuqi? Në këtë kuadër dua të theksoj që nisma e propozuar nga Këshilli i Ministrave është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Njëkohësisht kjo është në

përputhje me programin politik të qeverisë, me programin e përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, por njëkohësisht unë kam marrë edhe komunikatën e konferencës së fundit të mbledhjes së ministrave në Irevan që është mbajtur në datat 14 dhe 15 maj të vitit 2015 dhe përfitova nga rasti për të parë nëse ky projektligj mban parasysh edhe detyra që ka lënë konferenca e ministrave në konferencën e Irevanit të mbajtur pak javë më parë.

Gjithashtu, lidhur me mënyrën se si do të votohet ky projektligj dua t'ju bëj me dije se projektligji është një projektligj, i cili nuk përfshihet në ato pika që parashikon neni 81 i Kushtetutës për të pasur votim me shumicë të cilësuar. Pra, do t'i nënshtrohet miratimit, rregullave të përgjithshme, për sa i përket shumicës.

Nga pikëpamja e përmbajtjes dhe analizës së projektligjit unë dua të sjell në vëmendjen tuaj nenin 57, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila thotë se autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj. E përmenda këtë nen të Kushtetutës pikërisht për atë çfarë diskutohet dhe është debatuar gjerësisht, edhe në debate që grupi i ekspertëve, por edhe ministrja ka bërë në media me përfaqësues të universiteteve, apo dhe me profesorë të veçantë.

Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë. A e ruan këtë autonomi dhe lirinë akademike ky projektligj apo e cenon?

Së dyti, kam sjellë në vëmendjen tuaj jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe konkretisht vendimin nr.9 të kësaj gjykate, që daton në mars të vitit 2008, në të cilin gjykata arsyeton, dhe më lejoni t'ju sjell vetëm një paragraf, i cili është shumë i domosdoshëm për të kuptuar më pas disa pyetje që unë do të parashtroj në cilësinë e relatores; sipas arsyetimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, respektimi i parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë sanksionuar në nenin 57, pika 7 e Kushtetutës kërkon që ligji të krijojë dimensione të tilla që institucionet e arsimit të lartë të pajisen me pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime në mënyrë të lirë dhe të pavarur. Vetëqeverisja, kolegjaliteti dhe drejtimi i përshtatshëm akademik janë elementë thelbësorë të autonomisë së vërtetë për institucionin e lartë publik. Dhe në këtë analizë unë do të përqipem që në çdo çështje ose për pyetje që kanë t'i referohen këtij arsyetimi që i jep Gjykata Kushtetuese.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese më tej arsyeton se parimi i autonomisë universitare kërkon nga universitetet që të jenë subjekte të përgjegjshme dhe transparente në marrjen e vendimeve të tyre dhe në shpenzimet e fondeve. Kjo realizohet nëpërmjet mbikëqyrjes së

veprimtarisë së universiteteve nga organizma të ngarkuar për këtë qëllim, por kjo mbikëqyrje duhet të kryhet pa cenuar parimin e autonomisë universitare.

Lidhur me qëllimin dhe përmbajtjen e nismës ligjore unë nuk do të ndalem në mënyrë të detajuar, se çdo deputet e ka relacionin, por këtë e tha në mënyrë të përmbledhur edhe ministrija, edhe profesor Xhuvani, si përfaqësues i grupit të ekspertëve. Por, më lejoni të sjell në vëmendje disa risi kryesore të cilat ju ndoshta i prekët tangjent, por që kanë interes për publikun dhe këtë e kam për të sqaruar të gjithë kolegët, profesoratin e të gjitha universiteteve publike dhe private. Risia e parë dhe shumë e rëndësishme është rritja e lirisë akademike dhe e autonomisë financiare, organizative dhe e përzgjedhjes së personelit. Kjo është një risi që duhet vlerësuar shumë.

E dyta, është neutraliteti politik dhe ndalimi i veprimtarive politike brenda territorit të institucioneve të arsimit të lartë. Është hera e parë, është ligji i parë i arsimit të lartë që evidenton këtë parim kaq të rëndësishëm. Ne e dimë shumë mirë se çfarë problemesh kemi pasur me përfshirjen e politikës në universitetet ose në institucionet e tjera të arsimit të lartë.

E treta, është garantimi i arsimimit, jo vetëm për personat me mundësi financiare, por dhe për individët që plotësojnë kriteret për t'u pranuar në një nga programet e ciklit të parë të studimeve, por që nuk kanë mundësi financiare. Dhe kjo është për t'u vlerësuar. Dhe me këtë propozim që bëni në nismë, sinqerisht ju përgëzoj pasi i jepni mundësi një grupi të konsiderueshëm nxënësish që mbarojnë arsimin e mesëm, të cilët për shumë vjet nuk kanë pasur mundësi të ndjekin studimet vetëm e vetëm se familjet e tyre nuk kanë pasur mundësitë financiare.

Risia tjetër që duhet përmendur është se ligji për herë të parë krijon premisa që arsimi do t'u përgjigjet nevojave të tregut dhe kjo falë mbështetjes që do t'u jepet degëve të cilat janë në përputhje me prioritetet e zhvillimit strategjik të vendit. Po ashtu është për t'u përgëzuar unifikimi dhe standardizimi i sistemit të arsimit të lartë. Mundësitë e barabarta të meritës, një risi tjetër për të gjithë studentët që ndjekin arsimin e lartë. Edhe ky është një element që për herë të parë theksohet në ligj.

Heqja e Maturës Shtetërore që përflitet, duhet ta themi troç, unë nuk kam të drejtë të them ishte dështim apo sukses, por mendojmë se është zgjidhja më e mirë që po bëni për t'u krijuar mundësi universiteteve të kenë autonominë dhe lirinë e tyre për të vendosur se cilat do të jenë kriteret që duhet të përmbushin studentët që do të pranohen në ciklin e parë të studimeve. Dhe në këtë mënyrë unë kam bindjen absolute që ne do t'i japim fund analfabetizmit funksional

dhe afrimit në universitete të caktuara, qoftë në gjuhët e huaja, në arsim, të atyre nxënësve që kanë pikët më të vogla nga Matura Shtetërore. Por mos harroni se ne jemi të gjithë dëshmitarë, vijmë nga universitetet, studentët e shkollave në fshatra, komuna kanë pasur shpesh rezultate të Maturës Shtetërore shumë më të larta se në gjimnazet më të mira të Tiranës, çka tregon se me këtë zgjidhje që ju jepni në ligj, se zgjidhet një herë e përgjithmonë problemi i korrupsionit dhe dilema që ne kemi pasur vite më parë për maturën shtetërore.

Nga ana tjetër është risi krijimi i mekanizmit të qëndrueshëm të kontrollit brenda institucioneve të arsimit të lartë, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm, që tashmë ky institucionalizohet duke pasur struktura të cilat ju i vlerësoni të domosdoshme, permanente. Kjo është gjë e mirë, sepse do t'i japim fund asaj praktike që akreditohej njëherë fakultetet dhe pasi marrin akreditimin nuk i kushtojnë vëmendje rritjes së cilësisë së tyre.

Gjithashtu, krijimi i bazës financiare të qëndrueshme dhe mundësitë për të shfrytëzuar burime të ligjshme të financimit, pra diversiteti i burimeve të financimit që ju jepni në ligj është për t'u përshëndetur. Më së fundi universitetet do të kenë mundësi të ofrojnë ekspertizën.

Më lejoni të sjell një përvojë. Ne kemi ngritur në Kuvend një komision të posaçëm parlamentar për reformën në drejtësi, por deri më sot ju e dini që i gjithë procesi dhe dokumenti, analiza e problematikës është bërë nga ekspertët e nivelit të lartë që nuk kanë aspak lidhje me politikën. Janë profesorë, gjyqtarë, prokurorë të cilët kontribuojnë për të bërë reformën në drejtësi. Deri më sot me atë ligjin që është nuk u njihet kontribut, sepse ata vijnë, patjetër që i ka dërguar institucioni, por atë mundësi që të njihet, që të ofrojnë oponencat, krijon të ardhura që të rrisin mundësitë e të ardhurat e fakultetit, rrisin emrin e universitetit të tyre ligji i 2007-s nuk e mundëson. Ne të gjithë kemi kontribuar në target personal apo në kuadër të ftesave, por me risinë që ju sillni, që krijohen disa baza financimit dhe burime të financimit dhe jepni mundësi universiteteve që profesorët të japin dhe ekspertizë, të angazhohen, të bëjnë projekte, të zhvillojnë idetë e tyre bashkë me studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, kjo është risia më e madhe e cila më vjen keq që në këtë periudhë ka kaluar në heshtje dhe nuk është vlerësuar, madje është keqinterpretuar.

Gjithashtu, vlerësojmë faktin që për tarifën e studimit tashmë qeveria përcakton kufirin maksimal, gjë që u jep fleksibilitet institucioneve duke mos i vënë ato në pozita të pabarabarta dhe të mungesës së konkurrencës me fakultetet publike dhe jopublike. Gjithashtu më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj edhe një risi të këtij ligji dhe këtë e kam për të gjithë ata që na ndjekin

dhe konkretisht krijimin e fondit të mbështetjes së studentët. Studentët e shkëlqyer, studentët e programit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe për studentët në nevojë. Megjithatë unë kam dy pyetje më vonë duke marrë shkas dhe nga prezantimi që bëri profesor Xhuvani. Mundësia e kreditimit të studentëve është risi. Dhe kjo është për t'u vlerësuar.

Megjithatë mendoj se duhet të saktësojmë nëse do të bëhet kreditimi i të gjithë studentëve si ata që studiojnë në fakultetet publike dhe ato në jopublike apo jo. I thashë të gjitha këto risi pasi mendoj se shumë njerëz kanë folur për projektligjin, por nuk e kanë lexuar këtë projektligj. Dhe them se ky projektligj ka pësuar dhe shumë përmirësime nga variantet që shkaktuan debate të mëdha midis kolegëve të universiteteve. Megjithatë do të më lejoni të nderuar kolegë, meqenëse jemi komision që shohim kushtetutshmërinë dhe përjasjen e këtij ligji edhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese të ngrejë disa çështje për të cilat do të doja që sot ju por edhe nëse nuk mundeni sot pasdite, në ditët në vazhdim, por sa më shpejt t'i jepnit përgjigje disa pyetjeve që unë kam lidhur me nene të veçanta të këtij ligji. Por do të ndalem në çështjet parimore. Do e nis me statusin e institucioneve publike të pavarura të arsimit të lartë. Është risi, jam dakord me atë çfarë tha profesor Xhuvani, por për herë të parë ne krijojmë në ligj 3 lloje institucionesh. Institucione publike, jopublike dhe institucionet publike të pavarura.

Çështje me interes nga pikëpamja kushtetuese është a parashikon Kushtetuta pavarësi të institucionit të arsimit të lartë apo parashikon autonomi të institucionit të lartë. Besoj se e kuptojmë që autonomia dhe pavarësia nuk janë e njëjta gjë dhe nga kjo më lindin disa pyetje. Cili është modeli që ju keni marrë megjithëse në fjalën tuaj thatë ka shumë shtete që e kanë këtë model. Por flas për vende që siç jemi ne që kemi pasur vetëm institucione publike dhe më pas jopublike. Pse ka lindur nevoja në Shqipëri të parashikojmë përveç institucionit publik dhe jopublike dhe institucionin publik të pavarur? Cila do të jetë forma? Flas nga pikëpamja juridike, do të jetë ent publik, organizatë fitimprurëse, do të jetë shoqëri tregtare dhe cila do të jetë mënyra e krijimit të saj? Në varësi të përgjigjes që do të marr, mund të kem pyetje të tjera më pas që lidhen me Kodin Civil, me ligjin “Për shoqëritë tregtare”, me ligjin e prokurimit publik, me ligjin e OJF-ve. Pra, ka një sërë pyetjesh që lindin dhe duhet ta shohim ligjin më pas në përputhje dhe me kodin civil. Cili është dallimi midis institucioneve publike dhe institucioneve publike të pavarura? Cili është dallimi midis institucioneve jopublike dhe institucioneve publike të pavarura? Nëse do të pranojmë, mua më është krijuar përshtypja që kjo është OJF ose fondacion. Mua nuk më rezulton ent publik, sepse ju e përjashtoni nga rregullat e

prokurimit publik, në qoftë se e kam kuptuar qartë. Kur kemi institucione private pse duhet të kemi institucione publike të pavarura dhe cili do të jetë roli i ministrit përgjegjës të arsimit për të kontrolluar në këto institucione të pavarura. Deri ku do të shkojë kontrolli?

Gjithashtu, çështja e dytë ka të bëjë me sistemin e financimit dhe autonominë financiare. Ju parashikoni shpërndarje të fondeve publike në sektorin për universitetet, institucionet publike dhe jopublike. Por unë e kuptoj që marrin dhe këto institucionet publike të pavarura. Nuk i shikoj diku të përjashtuara që të marrin, madje marrin dhe prona, pasuri të paluajtshme, të cilat nuk kthehen asnjëherë atyre për çdo arsye. Kjo është një risi. Ju e jepni me ligj, ndërkohë që ka rregulla të veçanta se si jepet prona, pasuria e paluajtshme. Nuk mund t'i japë ky ligj i arsimit...

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, kur të merrni fjalën ju...

Vasilika Hysi – Zoti Fino, këto janë pyetjet që kam.

Pra, synimi i këtij projektligji është të alokojë fonde publike bazuar në konkurrueshmërinë midis universiteteve, treguesve të cilësisë etj. Megjithatë ju thatë që fondet e zhvillimit jepen vetëm për institucionet publike. Por unë nuk e kam të qartë dhe nuk më del e qartë: kreditë, fondet për ekselencën, mbështetja për studentët në nevojë do të jepet edhe për studentët që do të shkojnë në institucionet publike, edhe për ato jopublike? Kjo nuk del e qartë në ligj. Këtu rezulton që përjashtimi ose diferenca është vetëm për zhvillimin institucional të universiteteve publike.

Gjithashtu, lidhur me barazinë në treg të institucioneve dimensionimi i autonomisë universitare veç të tjerash ka të bëjë, shpreh dhe në të drejtën që kanë institucionet publike për të administruar fondet e tyre publike. Dhe unë kam një shqetësim lidhur me tarifat e shkollimit dhe mënyrën e vjeljes së tyre. Në qoftë se flasim për autonomi besoj se universitetet duhet të kenë të drejtë të administrojnë tarifat e shkollimit të tyre dhe nuk mund të vazhdojë ai fenomen që ka ndodhur deri më sot që universitete që kanë një prurje të madhe të studentëve, që kanë një tarifë të lartë shkollimi paratë merren dhe u jepen fakulteteve të cilat nuk kanë ato pagesa. Ju e dini që disa fakultete sot janë rinovuar, kanë ndryshuar infrastrukturën dhe fakultete që sigurojnë të ardhura kanë ngelur sikur të jenë në mjediset e shkollave 9-vjeçare të dikurshme. Çështja është te barazia në treg. Pse universiteteve jopublike nuk i ndërhyti, nuk i diktoni rregulla dhe tek universitetet publike ndërhyti dhe nuk shpreheni qartë për tarifën e shkollimit. Kanë të drejtë ta menaxhojnë? Kanë të drejtë ta përdorin? Kanë autonomi? Apo kjo do të merret? Sa përqind e

këtyre tarifave do t'u shkojë agjencive që krijohen? Agjencisë për shërbimet studentore ose agjencive të tjera?

Gjithashtu, meqenëse jemi në këtë kuadër sa përqind e fondeve publike do të shkojnë për universitetet jopublike dhe sa për universitetet publike? Ju nuk mund t'i përcaktoni në ligj dhe kjo është e drejtë, por disa kritere duhet të jenë të qarta në ligj. Në ligj ju thatë që disa agjenci krijohen, të tjera forcohen. A është parashikuar fatura financiare e këtij ligji? Kjo është një kërkesë që e kërkon Kushtetuta dhe që i bie ta diskutojmë ne në komisionin tonë.

Një çështje tjetër që dua të diskutoj, duke ruajtur të drejtën për të bërë pyetjet nen për nen, më pas është lidhur me programet e pranimit, diplomat dhe garantimin e cilësisë. Unë e përshëndes faktin që ju vlerësoni kriterin e mesatares dhe i lini institucionet të përcaktojnë kritere shtesë për pranimet në universitet. Vlerësoj faktin që keni bërë një larmi të gjuhëve që duhet të plotësojnë studentët që duhet të ndjekin ciklin e dytë dhe ciklin e tretë. Dhe që keni prishur ato që themi ne, preferencat, duke orientuar studentët se ku do ta mbrojnë gjuhën apo cilën gjuhë do të përdorë të mbrojnë etj. Më shqetëson një pikë e veçantë. Si do të përcaktohen, cilat do të jenë kriteret që do të përzgjedhin numrin e studentëve të ciklit të tretë të doktoraturës në fakultetet publike dhe jopublike? Do të vazhdojmë të kemi këtë pabarazi pavarësisht mundësive që kanë të mbështeten më shumë me doktoratura dhe automatikisht marrin dhe më shumë fonde sepse mbështeten dhe universitetet e tjera për doktoratura dhe kërkimin shkencor? Është me interes edhe të dimë dallimin midis masterit ekzekutiv dhe doktoraturës.

Çfarë ju ka shtyrë të fusni një koncept të ri, një master ekzekutiv, kur kemi kaq shumë mastera e kaq shumë programe në universitetet e Tiranës? Nuk e kam parë të rregulluar në ligj këtë dhe kjo është në kuadër dhe të përfundimeve të Konferencës së Jerevanit i japin mundësi studentëve që mbarojnë një lloj masteri, për të transferuar kreditet e tyre, njohjen nga master ekzekutiv në doktoraturë. Janë çështje që lidhen me të drejtat e individit, me lirinë akademike, me autonominë. Mendoj që këto duhen rregulluar.

E fundit fare është personeli dhe parimi i sigurisë juridike, parim kushtetues. Ju keni bërë një sërë rregullimesh në dispozitat kalimtare, për të cilat do të doja të diskutonim nen për nen, kur të vijë koha, por do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, që ditën e hënë, në këtë komision kemi filluar të diskutojmë ndryshimet në Kodin e Punës. Për fat, jam relatore edhe e atij projektligji, dhe shoh që nuk ka ndonjë koherencë midis rregullimeve që parashikon Kodi i

Punës lidhur me kontratat e punonjësve, me parashikimet që ne parashikojmë në ligjin e arsimit të lartë për kontratat e punonjësve, të pedagogëve.

Prandaj, do të ishte me interes që, meqenëse të dy projektligjet janë në diskutim, të koordinohen, sepse nuk shkojmë në të njëjtin kah lidhur me profesoratin, sidomos me profesoratin e ri ose me profesoratin që nuk ka përmbushur kriteret.

Të nderuar kolegë, këto ishin disa nga çështjet që ngrita në parim. Unë do të doja të theksoja se, me sqarimin e këtyre çështjeve, projektligji i propozuar vjen në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në diskutimin nën për nën rezervoj të drejtën për të bërë komente, pyetje dhe propozime për ndryshime. Më lejoni të falënderoj e të mirëpres në lidhje me sqarimet për këto pyetje, të cilat lidhen edhe me Kodin Civil, edhe me ligje të tjera, të cilat janë jashtë kompetencës së ministrisë suaj. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Falemnderit zonja Hysi për relatimin, për punën shumë serioze që kishit bërë lidhur me projektin, dhe që trajtuat një sërë çështjesh të rëndësishme, qoftë në këndvështrimin kushtetues, ashtu edhe në këndvështrimin e harmonizimit më të mirë të këtij projekti me kuadrin tjetër ligjor në fuqi! Një element i rëndësishëm, i cili besoj se është në vëmendjen e këtij komisioni dhe, gjithashtu, të përfaqësuesve të ministrisë e të ministrave personalisht, është ai që ka të bëjë me faktin se, paralelisht me këtë proces, është një proces tjetër që lidhet me reformën në drejtësi. Një nga komponentët më të rëndësishëm të atij procesi, është edukimi ligjor dhe arsimi juridik.

Unë shpresoj se në këto dy ditë do të kemi edhe një diskutim, posaçërisht, nëse ka nevojë për të interferuar disa nga gjetjet dhe problematikat e trajtuara nga ai grup pune në nivelin e zgjidhjeve konkrete.

Gjithsesi, besoj se do të ketë një reagim nga ana juaj, për sa u përket çështjeve apo pyetjeve të shtruar nga kolegja Hysi, edhe në cilësinë e relatores së projektit.

Lindita Nikolla – Falemnderit, zonja Hysi, për gjithë shpjegimin shterues që, përveç se tejet profesional në kuptimin ligjebërës, është tejet profesional edhe si akademike e spikatur!

Ju bëj me dije që hartimi apo draftimi i këtij projektligji – që sigurisht ka pasur kryefjalë të saj respektimin e Kushtetutës dhe i të gjitha referencave të Gjykatës Kushtetuese, që ju dhatë – është bërë nga përfaqësuesit më të mirë të jurisprudencës, pjesë e akademizmit shqiptar. Po ashtu, në përafrime e qasje tejet novatore me legjislacionin perëndimor evropian, bazuar në disa

modele, që profesor Xhuvani tha, modele që sot sigurojnë cilësi në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Sigurisht, ne do t'u japim një shpjegim shterues të gjitha pyetjeve që ju përcaktuat.

Kishit një mori pyetjesh, kшту që ne do t'i japim shpjegime shteruese me shkrim secilës prej pyetjeve, por lejomëni t'ju sqaroj një moment të veçantë, në atë çka ju thatë, që ky ligj sjell si risi. Nuk është vetëm procesi – ju e thatë; është edhe vetë produkti – sepse nuk mund të ketë një produkt jocilësor, kur një proces është gjithëpërfshirës dhe tejet cilësor.

Nga ana tjetër dua të diskutoje dhe një moment, që thatë se kanë ardhur disa drafte. Jo, nuk kanë ardhur disa drafte, por janë dy dokumente strategjikë, të përpunuar nga Komisioni i Reformës për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet tona të arsimit të lartë. Është një dokument i parë – ashtu siç ndodh rëndom, në fakt, në botën e qytetëruar – që iu dha për diskutim të gjitha institucioneve tona të arsimit të lartë. Është një dokument që është çuar në e-mailin e çdo institucioni të arsimit të lartë, pse jo dhe në e-mailin e çdo pedagogu, për të marrë feed back-un për këtë dokument. Më pas një dokument përfundimtar, që ka shërbyer si bazë, për të hartuar këtë projektligj, të cilin ne po diskutojmë.

Lejomëni, gjithashtu, t'ju bëj me dije se për këtë projektligj, nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë kanë ardhur në mënyrë shkresore, të shkruara, ndaj ne kemi një matricë të të gjitha problematikave që kanë ardhur nga të gjitha institucionet tona të arsimit të lartë, publik apo jopublik në vend. Më pas është bërë një proces maratonë, publik, i hapur edhe në prani të medieve, ku janë referuar sy më sy të gjitha vërejtjet që vinin nga institucionet tona të arsimit të lartë, dhe reflektimi nga Komisioni i Arsimit të lartë, por sigurisht edhe nga juristët që janë marrë me shkrimin e ligjit.

Pas këtij procesi, në Ministrinë e Arsimit ka vijuar edhe një herë një proces rakordimi i të gjitha vërejtjeve, për t'i reflektuar e për t'i draftuar në nene të veçanta të ligjit, e nga ana tjetër për të dhënë argumentet e komisionit e të grupit të ekspertizës aty ku këto vërejtje quheshin të panevojshme për t'u reflektuar në ligj.

Ndërkohë, duke admiruar pa dyshim, backgroundin tuaj juridik, por edhe akademik, lejomëni të them se nuk është e mundur që një projektligj të rrokë të gjithaq situatën, ashtu sikundër është e vërtetë ajo që thatë, se jo vetëm ligji bën të mundur atë ndryshimin e menjëhershëm në institucionet tona të arsimit të lartë, por është edhe një korpus nënligjor, të cilin ne po e hartojmë me ekspertët më të mirë të Bankës Botërore, e jo vetëm. Padyshim, edhe ai do të jetë – ashtu sikurse edhe procesi i parë i draftimit të projektligjit – një proces publik. Ju

dhe i gjithë publiku do të informoheni. Kjo është arsyeja, në fakt, që ky projektligj ka harkun e vet kohor për të hyrë në fuqi, pra futet në vitin e ardhshëm akademik, për t'iu lënë kohë të gjitha institucioneve tona të arsimit të lartë, që të reflektojnë, të vlerësojnë situatën reale në të cilën ato veprojnë, si dhe mundësitë e reja që duhet të përmirësojnë në kuadrin e ligjit të ri të arsimit të lartë.

Ndërkohë, lejomëni t'ju bëj me dije se kjo nuk është e vetmja fushë në të cilën po operon qeveria shqiptare dhe Ministria e Arsimit. Në kohën që ne flasim, kemi vënë rregull, në fakt, sepse kemi treguar një vullnet të qartë dhe të shprehur të respektit ndaj ligjit, sepse është ligji ekzistues i arsimit të lartë, që ishte shkelur me të dyja këmbët, dhe që kishte bërë që shumë institucione të arsimit të lartë të funksiononin pa asnjë referencë ligjore, pa asnjë kriter të standardizuar apo rigoroz të zbatimit të ligjit, gjë që çoi në mbylljen e tetëmbëdhjetë institucioneve të arsimit të lartë dhe në pezullimin e trembëdhjetë të tjerave.

Momentalisht, ju bëj me dije se të gjitha institucionet e mbetura, pra që funksionojnë, kaluan hapin e parë, atë të verifikimit të kriterëve të ligjit, një situatë që nuk kishte ndodhur kurrë më parë gjatë këtyre viteve në institucionet tona të arsimit të lartë, qofshin publike e qofshin private. Ne kemi ftuar dhe kemi kontraktuar agjencinë britanike, anëtare e ENCA-s, organizatës europiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, e cila do të bëjë një proces tjetër të akreditimit, procesin e verifikimit të kriterëve të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, sepse, sigurisht, ne ndajmë qasjen se për ne është e shtrenjtë çdo ditë në auditorët ku shkollohet gjenerata e re e shqiptarëve, dhe nuk presim që ligji të bëjë çudira, por çdo ditë të punojmë fort në rrugën e përmirësimit të standardeve jo vetëm ligjore, por edhe cilësisë në institucionet tona të arsimit të lartë.

Kështu që, në momentin që ligji i ri do të gjejë shtratin e vet, sigurisht pas vërejtjeve që do të vijnë nga ky komision, nga Komisioni i Medieve e nga ligjvënësit shqiptarë, ne do të kemi mundësinë – edhe pas finalizimit të këtij procesi të dytë që vjen nga agjencia britanike – të kemi një pamje shumë herë më të qartë, shumë herë më të plotë; institucionet vetë do të kenë një pamje shumë herë më të qartë, shumë herë më të plotë, për të implementuar më pas këtë ligj të ri, që është tejet sfidat dhe reformues, me një kah të vetëm, që është cilësia. Sigurisht, pa mohuar të drejtën e asnjë të riu e të reje shqiptare për të pasur një vend në institucionet tona të arsimit të lartë, por sigurisht një vend që sigurohet sipas meritës.

Lejomëni t'ju bëj me dije, gjithashtu, për pyetjen që ju kishit e që lidhej me autonominë, se kjo përbën një nga parimet thelbësore që ky ligj sjell, sa i takon zgjerimit të autonomisë. Në momentin që ne flasim, institucionet e arsimit të lartë kushtëzohen nga vendimmarrja e Ministrisë së Arsimit në përcaktimin e kuotave të pranimit. Edhe për mënyrën e pranimit, sepse edhe ju e shprehët se është matura shtetërore ajo që rreshton dhe liston studentët për t'u pranuar në degë e në institucione të ndryshme të arsimit të lartë. Është Ministria e Arsimit ajo që përcakton tarifat e shkollimit. Ligji i ri jo vetëm heq dorë, pra shteti, ministria, qeveria, jo vetëm që heqin dorë nga këto dy momente, duke ua lënë në dorë institucioneve të arsimit të lartë për të përcaktuar kriteret e pranimit, për të realizuar procedurën e pranimit, për të vendosur tarifat e pranimit – sigurisht duke vendosur një tarifë tavan e dysHEME, të përcaktuar nga qeveria shqiptare.

Nga ana tjetër, është institucioni i arsimit të lartë ai që promovon titujt akademikë, numrin e stafit, por edhe këtë moment tjetër që s'e përmenda. Sot e gjithë ditën është Ministria e Arsimit ajo që përcakton numrin e stafit në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Ky ligj e pamundëson Ministrinë që ta bëjë këtë, dhe është vetë institucioni i arsimit të lartë ai që orienton referencat dhe rekrutimin e stafit në institucione të ndryshme të arsimit të lartë.

Kemi një hap më të madh drejt zgjerimit të autonomisë universitare edhe me procesin e promovimit akademik, pra të titujve akademikë, duke hequr dorë nga ajo situatë tejte e vështirë – ashtu sikurse e thatë – e krijuar në këto vite, ku shpeshherë titujt akademikë nuk vireshin në shërbim të universitetit, në shërbim të kërkimit shkencor, por ishin në shërbim të administratës publike, për të marrë ca rroga më të mira, dhe asnjëherë nuk ktheheshin mbrapsht në investimin në universitet.

Ky ligj e rregullon këtë situatë jo vetëm duke ua lënë universiteteve këtë moment, por ajo që është e rëndësishme, duke e kthyer në një tregues të rëndësishëm të matjes së performancës së çdo universiteti, për të vijuar me skemën e financimit.

Me shumë të drejtë ju pyesni për skemën e financimit. Besoj se asnjë ligj i arsimit të lartë nuk ka përcaktuar skemën e financimit, në kuptimin e përcaktimeve precize të vlerave, por sigurisht ne kemi një skemë të mirëdetajuar në konceptin e parimeve dhe gjithë funksionalitetit. I jemi referuar një modeli, që është modeli anglosakson. Për institucionet e arsimit të lartë, përpara se të shkoj aty – sigurisht, e tha edhe profesor Xhuvani – 90% e institucioneve në Britaninë e Madhe veprojnë si të tilla. Institucione të nderuara dhe prestigjioze në Itali veprojnë si të tilla.

Institucione të nderuara në Francë veprojnë si të tilla. Shumica e universiteteve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë këtë profil. pa iu referuar emrit që ne i kemi vënë, institucion i arsimit të lartë publik të pavarur. Ai është një emërtim, por sigurisht ju nuk niseni nga emërtimi, kur krijoni gjithë përfytyrimin se si do të operojnë këto institucione të arsimit të lartë, sepse janë funksionaliteti, fusha e veprimit dhe parimet mbi të cilat ngrihen këto institucione të arsimit të lartë.

Ajo që unë dua të them është se ky ligj nuk detyron asnjë institucion të arsimit të lartë, që të kthehet në institucion të arsimit të lartë publik, të pavarur. Përkundrazi, ky është një nocion novator. Ligji mundëson një afat kohor të përcaktuar, tre deri në pesë vite për institucionet e arsimit të lartë, që të shëndoshen. Është një hapësirë e re dhe një mundësi e re për çdo institucion, që është në vendimmarrjen e institucionit nëse do apo jo të shndërrohet në një institucion të arsimit të lartë publik të pavarur. Kur themi shndërrimi në institucion publik të pavarur, do të thotë se mund të ketë edhe institucione të arsimit të lartë, që sot e gjithë ditën veprojnë si institucione fitimprurëse, të cilat pas një seti të përcaktuar rregullash do të kërkojnë të kthehen në institucione të arsimit të lartë publik, ku një moment tejte i rëndësishëm është heqja dorë nga fitimi, pra, kthehen në institucione jofitimprurëse. Vetëm atëherë fillon funksionimi i skemës së re që lidhet me institucionet e arsimit të lartë publik të pavarur, gjë të cilën do ta shtjellojë në mënyrë më të detajuar juridike zoti Ndreca.

Ndërkohë, ju pyetët në lidhje me tarifën e shkollimit. Edhe sot ligji aktual, por edhe në ligjin e ri, gjithë tarifa që institucionet publike të arsimit të lartë mbledhin nga tarifa e shkollimit, mbetet në dorë të institucioneve të arsimit të lartë, dhe është vendimmarrja e tyre, liria e tyre dhe autonomia e tyre që ta ndajnë sipas nevojave. Por ajo që nuk ka ndodhur dhe që ligji i ri e sjell është jo vetëm verifikimi se si dhe sa zbatohen, dhe këto financa vijnë në funksionalitet të nevojave që institucionet e arsimit të lartë kanë, por ligji i ri përmes kodit të cilësisë dhe një seti të trupëzuar të standardeve që janë njësoj si për publikun dhe për privatin, mundëson, për verifikimin e kriterëve të cilësisë, por jo për financat. Pra skema e financimit lidhet vetëm me institucionet e arsimit të lartë publik të mos krijojmë asnjë lloj dileme. Nëse ka dilemë unë, Ministria e Arsimit, qeveria shqiptare ka shprehur në mënyrë të prerë një “jo” të madhe. Nuk ka para të taksapaguesve shqiptarë që shkojnë për institucione private, përkundrazi ka diversifikim të burimeve të financimit që vijnë nga publiku dhe privati për të shëndoshur institucionet tona të arsimit publik. Më lejoni t’ju bëj me dije se kjo është e mundur. Ne kemi realizuar edhe një

tryezë me partnerët tanë të rëndësishëm socialë, me biznesin po ashtu, të cilët jo vetëm e kanë mbështetur këtë ligj, por nga ana tjetër kanë krijuar një korpus të rëndësishëm për të mësuar që me implementimin ligjit ato të jenë në krah të institucioneve të arsimit të lartë publik për të mundësuar atë që ju e thatë, bashkërendimin, një gjë që i ka munguar këtij vendi të profileve të cilësisë së diplomave me tregun e punës. Ligji e lidh në mënyrë integrale duke e kthyer gjurmueshmërinë e punësimit të çdo studenti që del nga institucionet tona të arsimit të lartë në një kriter matjeje për performancën, gjë që ka munguar deri më sot, ndërkohë që ngarkon qeverinë për të përcaktuar në mënyrën transparente letrën e prioriteteve që përcakton hapur dhe bën qartazi për çdo të ri dhe të re shqiptarë, se cilat janë profilet që sot janë të qasura me tregun e punës dhe kush janë profilet që kanë prioritet për zhvillimin e vendit. Për sa i përket pyetjes që ju bëtë, pra jo çdo gjë që lidhet me skemën e financimit ka referencë vetëm për institucionet e larta të arsimit publik. E përsëris edhe një herë, çdo gjë që lidhet me skemën e financimit ka referencë institucionet e arsimit të lartë publik. Nëse pas 3 apo 5 vjetëve kjo mundësi mund të shfrytëzohet dhe sigurisht është një hap përpara tejet inovator që qeveria shqiptare bën për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë duke krijuar këtë institucion të ri që ne e kemi quajtur Institucion të Arsimit të Lartë Publik të Pavarur, në referencë të atyre modeleve që unë thashë më sipër. Unë mendoj se është pjesa më revolucionarizuese e të gjithë sistemit tonë që institucionet tona dhe ato që kanë mbetur dhe ato që do të mbesin pas verifikimit të cilësisë nga agjencia britanike, që institucionet e arsimit të lartë privat të kenë mundësinë të çlirohen nga kjo situatë e qenies si fitimprurës për të kaluar në një status të ri me një set shumë të qartë dhe me filtra shumë të qarta publik që do t'i sqarojë zoti Ndreca dhe më pas ne vijmë në një situatë të re, të cilën do ta sqarojmë në të gjitha hapat e skemës së financimit. Është një mundësi, nuk është detyrim që buron nga ligji, është një derë e hapur është një mundësi që ky ligj u jep të gjitha institucioneve të arsimit tonë të lartë për t'u qasur me ato institucione, sepse pse jo edhe Shqipëria, edhe studentët shqiptarë që të mos kenë referenca vetëm modelet që funksionojnë në vendet europiane, por ato mundësi t'i kenë edhe në vendin e tyre në kuptimin e standardeve të reja të funksionalitetit.

Për sa u përket kredive studentore, sigurisht referenca është vetëm publiku. Çdo gjë që thuhet në këtë ligj dhe që ka të bëjë me skemën e financimit referenca janë vetëm institucionet publike, të nderuar deputetë. Kapitulli XII, është një mundësi e re që i lihet hapur institucioneve tona publike, institucioneve tona private për ta zgjeruar autonominë e tyre deri në kufijtë e lirisë,

për ta bërë konkurrencën më të drejtë dhe sigurisht, me një set të qartë dhe me filtra të qartë për të shkuar në këtë gjendje dhe status të ri që do ta sqarojë zoti Ndreca.

Unë ju falënderoj!

Ndërkohë do të kemi në shikim përgjigjet për pyetjet që bëtë, ju, zonja Hysi, pasi ishin të shumta dhe nuk mund t'i shterojmë të tëra.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Relatorja nuk kishte për qëllim që të ngrinte disa pyetje, që do të marrin thjeshtë përgjigje, pasi më shumë kërkon të ngacmojë debatin që do të kemi nën për nen.

Plarent Ndreca- Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të doja të falënderoja zonjën Hysi, për citimin që i bëri vendimit nr.9 të Gjykatës Kushtetuese. Në fakt, secili prej elementeve që ju cituat, që Gjykata Kushtetuese ka vendosur, janë respektuar me rigorozet dhe besnikëri shumë të qartë. Pra, që te neni i parë dhe deri te neni i fundit i këtij ligji, autonomia është respektuar.

Për sa i përket pyetjes që a e parashikon Kushtetuta autonominë, apo pavarësinë sigurisht që Kushtetuta përcakton standarde minimale për t'u respektuar nga shteti, dhe ka përcaktuar qartë që shteti duhet të garantojë dhe respektojë minimumin, që është autonomia institucionale. Patjetër që lejon hapësira dhe mundësi për të kapërcyer këtë dhe për të shkuar më tutje. Ju jeni të gjithë të qartë që IAL-të private janë të gjitha të pavarura. Ne, shteti, ministria, ka detyrim për të garantuar autonominë institucionale në këto institucione, sepse autonomia institucionale sipas Kushtetutës nuk është vetëm për publikun është edhe për privatin, por mënyra e funksionimit dhe strukturimi patjetër që kanë një liri të plotë në këtë aspekt.

Pse ka lindur nevoja për IALPP-të? Praktikisht ne sot nuk kemi institucione të arsimit të lartë publik. Praktikisht nga mënyra se si kontrollohen, financohen, organizohen, janë institucione shtetërore. Pra këto institucione që ne sot kemi në tregun publik janë shtetërore. IALPP-ja është një mundësi e re institucionale për të krijuar dhe për ta bërë më të zhdërvjellët nga ana financiare funksionimin e këtyre institucioneve. Pra, ne kemi krijuar një hapësirë lirie që këto institucione të vetëfinancohen dhe vetëmenaxhohen, në mënyrë që të kenë lirshmëri në realizimin e projekteve të tyre. siç e tha zonja ministre e re

Në lidhje me kontratën punës që ju përmendët, në ligj janë respektuar parimet e Kodit të Punës aktual në fuqi. Ne nuk jemi në dijeni të ndryshimeve të Kodit të Punës por nuk besoj se ka ndryshime të parimeve të Kodit të Punës, që janë parime që burojnë nga Kushtetuta. Ne jemi

përpjekur se ky është ligj që nuk rregullon marrëdhëniet e punës, pra nuk është ligj për njerëzit dhe për marrëdhëniet e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në lidhje me kontratat e punës nuk ka asgjë në kundërshtim me Kodin e Punës, kemi respektuar punimet e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë.

Lidhur me tarifat e shkollimit, ata janë administruar edhe sot që flasim me ligjin aktual. Sigurisht që ligji i ri nuk e cenon këtë madje i jep një frymëmarrje tjetër.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera? Po, zoti Manja.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Unë përgëzoj ministren dhe stafin për projektligjin. Sigurisht kam mendimin që një projektligj kaq i debatuar për gatë 2 vjet, sigurisht që është një projektligj me brendi dhe produkt dhe unë nuk kam as më të voglin dyshim në produktin e tij. Se çfarë ka ndodhur me arsimin e lartë në Shqipëri mjafton të shoh nenin 122, të projektligjit ku flitet për dispozitat kalimtare dhe të fundit ku janë dashur 6 pika të nenit 122 të integrojnë diplomat që janë lëshuar në Shqipëri në këto 10 vjet. Është një katrohurë diplomash, por gjithsesi, pyetja ime është shumë e thjeshtë, zonja Ministre, a mendoni se me këtë projektligj prindërit shqiptarë duhet të jenë të qetë se investimi që ata do të bëjnë me shumë sakrifica për fëmijët e tyre, tani e mbrapa nuk do të jetë një investim me një diplomë pa vlerë, por në një diplomë të konkurrueshme në tregun e madh evropian?

Fatmir Xhafaj – Po faleminderit, zoti Manja!

Zonja Ministre një përgjigje koncize.

Lindita Nikolla – Patjetër, prindërit shqiptar do të jenë më të qetë pas implementimit të këtij ligji, por jo thjesht ligjit por të gjithë situatës dhe korpusit të masave që qeveria shqiptare ka adresuar në kuadrin e reformës së arsimit të lartë, sepse studentët janë në qendër të kësaj reforme dhe e përsëris që çdo kohë e shpenzuar si kohë studimi do të jetë një kohë reale që do të mundësojë kthimin mbrapsht të gjithë investimeve në kohë dhe në financa, jo vetëm në cilësinë e diplomës por do të ketë edhe cilësi diplome që është e qasur me tregun e punës. Qeveria shqiptare do të ketë detyrimin jo vetëm kontrollin e ligjit dhe kontrollin e të gjitha standardeve të cilësisë, por do të ketë detyrimin edhe të anketimit të studentëve dhe përcaktimit të letrave prioriteteve siç e thashë pak më parë duke i kthyer këto në instrumente të rëndësishme të performancës së punës së çdo institucioni të arsimit të lartë. Nuk do të kemi më skemë financimi

që do të lidhet me autputet sa studentë futëm në shkollë të lartë, por një skemë financimi që bazohet në rezultatin dhe të gjithë treguesit e performancës. Sigurisht e gjithë kjo situatë do t'i bëjë më të qetë jo vetëm prindërit shqiptarë, por të gjithë shoqërinë shqiptare që më në fund do të kemi një situatë të re që lidhet me tërë formimin e kapitalit të çmuar njerëzor të këtij vendi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Qefaliaj.

Xhemal Qefaliaj – Faleminderit!

Unë kam një pyetje disi ndryshe. I kemi parë deputetët e opozitës që kanë dalë në medie dhe e kanë kontestuar këtë draft. Do të doja informacion nga ju, a kanë pasur dijeni se fakti që erdhën dhe ikën dy dhe që u larguan, a keni ndonjë informacion pse janë larguar ose a mund të marrim ndonjë përgjigje nëse janë dakordësuar me këtë risi që sjell Ministria e Arsimit? Pyetja e parë ishte për ju zonja Minushe.

Pyetja e dytë ka të bëjë me atë që u tha edhe nga kolegët parafolës. Ky është me të vërtetë një revolucion që po i bëni legjislacionit për të normuar punën në Ministrinë e Arsimit dhe në arsimin e lartë. Një risi që është evidentuar është fakti që administrimi i këtyre institucioneve të arsimit të lartë është bazuar në dy shtyllat kryesore, te rektori dhe administratori. Cila është arsyeja që është menduar që të bazohet në këto dy shtylla?

Fatmir Xhafaj – Po. Faleminderit!

Zonja Ministre.

Lindita Nikolla – Sigurisht janë referenca të modeleve bashkëkohore, të cilat funksionojnë sot në institucionet e arsimit të lartë, por edhe për të mundësuar që rektori dhe stafi akademik të jetë i fokusuar në punën akademike duke hequr dorë nga gjithë veprimtaria tjetër që lidhet me tenderët, investimet e kështu me radhë. Pra do të ketë një bord administrimin. Pra, dhe një administrator, i cili do të mundësojë realizimin misionit të universitetit duke realizuar të gjithë procesin që lidhet me administrimin, do të kemi struktura modernizuese konform modeleve të cilave ne i jemi referuar e në fakt është edhe një mundësi e re kjo për të standardizuar të gjithë sektorin e arsimit të lartë dhe për të përcaktuar përgjegjësinë sepse sot me ligjin aktual përgjegjësia mbetet ende një nocion anonim në kuptimin e funksionalitetit qoftë akademik, qoftë të anës ekonomike që lidhet me funksionalitetin e arsimit të lartë.

Fatmir Xhafaj – Po. Faleminderit!

Besoj se ajo që zoti Qefaliaj e trajtoi në formën e pyetjes, më shumë se sa një pyetje kam përshtypjen se është një shqetësim për praninë e opozitës këtu, në këtë mbledhje. Besoj se ndajmë të njëjtin mendim se opozita do të duhej të ishte sot këtu, ashtu siç do të duhet të jetë normalisht në të gjithë aktivitetin parlamentar, por më tepër në një ligj të tillë të rëndësishëm, siç është ligji për arsimin e lartë, për shkak se ky nuk është një ligj as për Partinë Socialiste, as për Partinë Demokratike. Ky është një ligj për qytetarët shqiptarë, është një ligj për të sotmen por mbi të gjitha një ligj që ka të bëjë me të ardhmen e vendit dhe si i tillë kërkon shqetësimin jo vetëm të qytetarëve e prindërve, por para së gjithash, dhe mbi të gjitha edhe të përfaqësuesve të tyre në këtë institucion të rëndësishëm siç është Kuvendi i Shqipërisë. Por kjo mbetet në çmimin e opozitës për qasjen, për sjelljen e saj në raport me tema të rëndësishme që prekin dhe që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me fatet e vendit dhe me interesat e qytetarëve. Unë për një gjë jam i bindur që opozita ditën që do të jetë ky ligj, do të vijë në parlament, do të flasë për arsimin e kapur, për dështim, për lloj – lloj gjërash, por unë do të preferoja dhe të gjithë do të preferonin që të shihnin këtu një opozitë aktive dhe në një mbledhje komisioni një rol shumë më konstruktiv për ta përmirësuar ligjin. Me këtë rast dua të them edhe për ju edhe për kolegët, se unë nuk di deri më sot në historinë njerëzore të ketë një ligj perfekt. Nuk ka sesi të ketë një ligj të tillë. Ka ligje të mira në interes të vendit, të qytetarëve dhe siç përsoset dhe si zhvillohet vetë shoqëria njerëzore ashtu përsosen edhe ligjet që shoqëria i ka të nevojshme për të rregulluar marrëdhënie të caktuara. Në këtë kontekst, ky proces do të ketë të nevojshëm diskutimin, debatin edhe nen për nen për ta përmirësuar ligjin në kufijtë e zgjidhjeve parimore që ka dashur dhe dëshiron të japë.

Opozita do të ishte e mirëpritur, por ky është një proces që nuk ka të bëjë me garantimin e karrigeve të opozitës apo të maxhorancës, por është një proces që dëshiron të garantojë një nivel më të lartë, më cilësor në arsimin e të rinjve shqiptarë.

Po, zoti Lutaj.

Piro Lutaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Ministre, unë i bashkohem komplimenteve dhe vlerësimeve shumë pozitive që bënë kolegët lidhur me këtë projektligj që keni paraqitur këtu, të cilën po e diskutojmë. Që të jem konkret, kam dy pyetje që kanë të bëjnë me organizimin e institucioneve të arsimit të lartë. Ju keni përcaktuar në njërin prej neneve se si organizohen institucionet e arsimit të lartë dhe thoni se bëhen konform kërkesave të këtij ligji në pikën e parë të dispozitës, ndërkohë thoni se

janë tri institucione të arsimit të lartë: institucionet publike të arsimit të lartë, institucionet jopublike të arsimit të lartë, dhe institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë. Pyetja ime është se me çfarë aktesh krijohen dy institucionet e para? Për arsye se institucioni publik i arsimit të lartë krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pyetja e dytë, çfarë ndryshimi kanë ose çfarë të veçante paraqit institucioni publik i pavarur i arsimit të lartë, përveçse ai miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, a ka ndonjë gjë në thelb përveç këtij akti formal?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Lutaj!

Po, zonja Ministre.

Lindita Nikolla – Është ashtu sikurse tha zoti Lutaj, institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat, jopublik janë institucione që ekzistojnë sot. Institucioni i ri që krijohet në kapitullin e 12-të është një mundësi, e sqarova pak më parë. Megjithatë, meqenëse ju insistoni në termat juridike, zoti Ndreca do të sqarojë detajet.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Ndrecaj.

Plarent Ndrecaj - Të dy institucionet publike, pra edhe ai që ne e quajmë institucioni publik dhe ai publik i pavarur, krijohen nga Këshilli i Ministrave. Institucionet publike edhe me ligjin aktual krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, licencohen nga Këshilli i Ministrave, madje edhe privatët për aktivitetin në këtë fushë licencohen nga Këshilli i Ministrave. Për sa i përket personit juridik, besoj se ju e kishit për personin juridik dhe jo për IAL-në, sepse kjo e fundit është e qartë dhe bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personi juridik tek institucionet jopublike, pra ato private krijohet sipas ligjit “Për shoqëritë tregtare” apo ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse”, pra sipas Kodit Civil.

Risia e IALPP-ve është fakti që duhet të bëjmë një dallim shumë të qartë midis IAL-së me themeluesin që është fondacioni. Ne kemi parashikuar që një IAL të shkojë në Këshillin e Ministrave, të licencohet dhe të krijohet si e tillë duhet që të themelohet vetëm nga një fondacion. Është fondacioni i cili do të ketë mundësinë të shkojë në Këshillin e Ministrave për të kërkuar licencimin e një IAL-je. Kjo nuk është bërë pa qëllim, sepse është e vetmja formë që garanton pavarësi absolute në menaxhimin e fondeve, të mirave materiale, të drejtave e të tjera që janë të pakthyeshme mbrapa nga fondatori.

Në këtë aspekt besoj se kemi arritur të ndërtojmë një ekuilibër shumë të drejtë midis pavarësisë, mundësive, por edhe duke ruajtur përgjegjshmërinë në këto institucione, si edhe kontrollin.

Për pyetjet që bëri zonja Hysi ne do të flasim në mënyrë shumë të detajuar. Unë do të thosha një element që një IALPP është në bordin e administrimit, pasi është gjithmonë një anëtar i ministrisë i përcaktuar me ligj. Sido që të krijohet IALPP-ja një anëtar i ministrisë është për të ushtruar konceptin e rregullatorit për të ushtruar një ndër kompetencat që ka ministria, qeveria, pra atë të rregullatorit. Ai do të jetë aty si përfaqësues i rregullatorit, që në këtë rast është ministria.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, zonja Agalliu.

Anila Agalliu - Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin që i bëtë projektligjit “Për arsimin e lartë.

Nenin 112 i projektligjit bën fjalë për kredinë studentore, ndërkohë te neni që i përket Agjencisë Kombëtare të Financimit thuhet se kjo agjenci një ndër funksionet e saj ka garantimin e kredisë studentore. Kjo kredi studentore është për të dyja nivelet e studimeve për ciklin e parë dhe të dytë. Pyetja ime është, a ka ndonjë model sesi do të jetë kjo kredi studentore?

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja Ministre.

Lindita Nikolla – Në fakt është një pyetje shumë teknike, Ka modele dhe sesi do të bëhet kjo, do të përcaktohet me aktet nënligjore. Modelet janë rëndom në të gjitha institucionet tona të arsimit të lartë. Ne do të kemi referencat më të mira të këtyre modeleve, aty ku funksionon kredia studentore, por pa shkuar te kredia studentore janë dy momente të rëndësishme që ky ligj u adresohet. Gjithë studentëve që kanë pamundësi financiare për të mundësuar financimin e studimeve në arsimin e lartë, por kanë meritën, skema e re e financimit i akordon bursën dhe nga ana tjetër ata studentë që vijnë nga këto shtresa kanë mundësinë përsëri përmes bursave të vijnë studimet e tyre në degët prioritare që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pra me aktet nënligjore. Nuk përcaktohet në ligj mënyra sesi do të operohet me kredinë studentore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Xhuvani për të sqaruar diçka.

Aleksandër Xhuvani – Për të sqaruar çështjen akademike, meqenëse jam akademik, desha të them diçka për atë që ka të bëjë me master ekzekutiv për të cilën pyeti zonja Hysi. Cili është modeli dhe pse duhet master ekzekutiv?

Së pari, ka ekzistuar edhe në vitin 2007 dhe pastaj në vitin 2010 u amendua në një kohë që shumë studentë shqiptarë e kishin përfutur masterin e nivelit të dytë. Në të gjithë Europën masteri i nivelit të dytë nuk ka lidhje me doktoraturën, po është një formim që i adresohet drejtpërsëdrejti tregut të punës, por në nivelin më të lartë. Po marr një rast, një student fillon studimet në mjekësi, bën pesë vjet dhe pastaj e shikon që vokacioni i tij i jetës nuk është të qenit mjek, por do të bëhet drejtor i spitalit, atëherë pas masterit bën një master ekzekutiv në menaxhimin spitalor dhe kandidon për t'u bërë drejtor i spitalit. Në Francë është përvoja më e madhe, edhe ajo ka filluar të kritikohet, por gjithsesi ka funksionuar është Shkolla Kombëtare e Administrimit, e cila pas masterit formon drejtuesit më të lartë të administratës shtetërore, jo vetëm shtetërore, por edhe private. Të gjithë drejtorët e ekuivalentit të KESH-it janë të dalë nga këto shkolla që janë master ekzekutiv, pra master i nivelit të dytë, i një niveli shumë të lartë, i cili orientohet nga tregu i punës dhe nuk ka lidhje me doktoraturën. Doktoraturës ne i kemi hequr 60 kreditet e formimit, sepse nuk kishte vend në botë që kishte 60 kredite formim në doktoraturë. Edhe një britanik na bëri një pyetje, në njëfarë mënyre na vuri në pozitë të vështirë, ai tha, nga do t'i merrni pedagogët për ciklin e tretë? Do t'i merrni nga Marsi? Sepse në tokë deri në ciklin e dytë mund t'i japin. Doktoratura është thjesht projekti kërkimor i madh që ka departamenti për të cilin merr financimin dhe në varësi nga projekti, personeli akademik mund të jetë tutor i punimit të doktoraturës, merr financimin, propozon projektin dhe për këtë projekt shkruhet teza e doktoraturës. Teza e doktoraturës propozohet të hiqet përfundimisht nga korniza e punësimit pasi për sa i përket kësaj të fundit ata që përfundojnë doktoraturën e kanë karrierën dhe vendin vetëm në universitet ose në institucionet e larta të kërkimit shkencor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime? Kolegët bënë një kombinim midis pyetjeve dhe diskutimeve. Besoj se u ezauruan edhe ato. Kështu që e mbyllim këtu pjesën e diskutimeve.

Para se të votojmë dëshiroj të trajtoj dy gjëra. Çështja e parë, krahas kushtetutshmërisë dhe përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, është detyrë prioritare për ne si komision, të jemi

të vëmendshëm për të parë edhe çështje që janë ngritur nga kolegët dhe relatorja dhe që do të trajtohen më me kujdes gjatë shqyrtimit nën për nën. Personalisht, e ritheksoj se nuk ka një ligj perfekt dhe nuk duhet të mendohet se do të ketë ndonjëherë një ligj të tillë, por ky në vlerësimin tim, është një ligj i mirë. Unë e kam parë me kujdes dhe është një ligj i mirë. Ka vende për t'u plotësuar, për t'u përmirësuar, por në thelbin e tij dhe në strukturë është nga ligjet e mira që unë kam parë të vijnë në parlament gjatë këtyre viteve.

Së dyti, më duhet të them se bëj pjesë tek ata partizanë të strukturave apo të zgjidhjeve që janë të koklavitura, por për zgjidhje që janë më të thjeshta dhe që kanë një qëllim: cilësinë. Ne sot kemi një problem shumë të madh. Ne mund t'i mbyllim universitetet, mund t'i mbajmë të hapur, mund t'i bëjmë publike, jopublike, por kemi problem cilësinë e diplomave. Të flasim hapur. Të jemi të ndershëm. Sot që flasim nëse do duhet të rekrutojmë njerëz që të shkruajnë, të bëjnë një dokument, një *concept paper* edhe nga studentët që mbarojnë Juridikun, më vjen keq, këto ditë kemi bërë disa prova, disa thirrje publike për të rekrutuar njerëz të tillë edhe në kuadrin e reformës në drejtësi dhe jam i keqardhur të shoh se e kemi shumë të vështirë për ta bërë këtë gjë. Ky është problem shumë i madh. Cilësia është problem shumë i madh. Nuk kanë rëndësi detajet sesi do të formatohen, sesi do të emërtohen, por rëndësi ka cilësia. Një student te ne e ka të lehtë ta marrë diplomën, siç marrim çdo gjë tjetër në jetë këtu në vendin tonë, pra, për fat të keq e kemi shumë të lehtë të marrim edhe një diplomë. Unë e shikoj se hyjnë 100 studentë dhe në rastin më të mirë mbesin 10 % e tyre.

Po marr një vend që kam një përvojë konkrete Gjermaninë, po deshët edhe Bokonin, që e përmendët si një tip i veçantë i organizimit që kam pasur rast ta ndjek nga afër, për interesat e mia, shoh që hyjnë 100 dhe dalin 10, raporti është krejt i kundërt me këtë që kemi ne sot, nga ajo që ne prodhonim diploma si kartëmonedha false, siç bënim dikur në tregun e zi për pasaportat. Kjo që kemi sot është pakrahasimisht shumë cilësore dhe shumë e rëndësishme, një hap i jashtëzakonshëm përpara, por nëse flasim për një vend që do të jetë pjesë e tregut të punës dhe e konkurrencës në shoqërinë e ardhshme europiane dhe më gjerë, padyshim problemi themelor nuk duhet të jetë: a jepen apo jo diploma të falsifikuara, por cilësia e tyre, cilësia e djemve dhe e vajzave që dalin nga auditorët e universitetit, gjë që reflektohet edhe në cilësinë e jetës, e menaxhimit të shoqërisë.

Po marr fushën që kemi specifike, drejtësinë, çfarë ndodh sot? Nëse sot kemi një problem shumë të madh me drejtësinë, është edhe ajo e pamjaftueshmërisë profesionale. Kemi

sot gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, përmbarues që e kanë marrë atë titull, kanë diplomën, kanë vitet, janë thirrur të japin drejtësi apo të shërbejnë për drejtësinë dhe janë të paaftë profesionalisht. Është absurde që në vitin 2014 progresraporti i BE-së të shkruajë se ka probleme në cilësinë e të shkruarit të gjyqtarëve në dhënien e vendimit, në arsyetimin e vendimit. Pa dyshim ka shumë faktorë, nuk janë përgjegjës vetëm universitetet, vetëm arsimi i lartë, por besoj se ka rolin e vet në këtë gjendje edhe cilësia e arsimit të lartë. Në këtë kontekst mendoj se ka disa elemente që do të duheshin të forcoheshin më shumë në projektligj. Ministria duhet të jetë e hapur për ta parë më me dashamirësi, si edhe vërejtjet dhe sugjerimet që do të bëjnë kolegët.

Ajo që kam si sugjerim është të shkojmë në këtë kahje, sesi të forcojmë mësimdhënien dhe kontrollin e dijeve në universitet për të nxjerrë studente dhe studentë shumë më të formuar cilësisht. Në funksion të saj, ne kemi një ndjeshmëri, por kemi edhe një sfidë që ka të bëjë me çështjen e reformimit të sistemit të drejtësisë. Siç e thashë që në fillim, një prej komponentëve më të rëndësishëm të kësaj reforme është ajo që ka të bëjë me edukimin juridik dhe arsimin e lartë juridik.

Do të dëshiroja që në ditët në vijim, ndoshta këtë të premte apo në fillim të javës të kemi mundësinë që me komisionin përkatës, i cili drejtohet nga profesoreshë Aurela Anastasi, në përbërje të të cilit janë disa nga pedagogët dhe pedagoget më të njohura të sistemit të drejtësisë në vend, njerëz të praktikës, të bëjmë një diskutim për të parë nëse ka gjëra që duhet të përputhen midis produktit të nxjerrë, analizës që ka prodhuar ai komision dhe asaj çfarë kemi në këtë projekt.

Zonja Ministre, do të dëshiroja të ketë një përfaqësues tuajin, i cili të jetë i pranishëm, në pamundësi tuajën për shkak të angazhimeve të shumta personale në cilësinë e titullares së këtij dikasteri të rëndësishëm, por të paktën të jenë një ose dy përfaqësues. Aty kemi edhe ish-anëtarë të Komisionit për Arsimin, që të arrijmë të rakordojnë, në mënyrë që të mos bëjmë ndryshime në një fazë të dytë të ligji “Për arsimin e lartë”.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Mbyllet shqyrtimi në parim, për të kaluar javën e ardhshme në shqyrtimin në për nen të këtij projektligji.

Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, profesor Xhuvani!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Faleminderit, zoti Sekretar i përgjithshëm!

Falënderoj kolegët për impenjimin!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e medias që ndenjën urtë sot!

Mbyllet mbledhja.

MBLEDHJA MBYLLET